



**RAPORT
MONITORIMI I SEKTORIT TË
MJEDISIT NË KOMUNËN E
GJAKOVËS**

2024

MAJ, 2025



RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS – 2024

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771

Maj, 2025

PËRMBAJTJA :

HYRJE

GJETJET E RAPORTIT

- 1 Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
Statistikat Kryesore - 2024:**
- 2 Korniza ligjore**
- 3 Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**
- 4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
Raportet mjedisore në nivelin lokal**
- 5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave**
- 6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**
- 7 Licencimi dhe lejet mjedisore**
- 8 PËRFUNDIME**
- 9 REKOMANDIMET**

HYRJE

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunat e Kosovës. Disa nga komunat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Gjakovës, organi përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor është Sektori për Mbrojtje të Mjedisit, i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM). Megjithatë, për këtë raport nuk është pranuar përgjigje nga DUMM. Informacioni i siguruar është ofruar nga Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike (DShP). Ky sektor ka gjithsej 6 punonjës, prej të cilëve 3 janë të angazhuar në menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtjes së Mjedisit	/
Sektori	Jo	Sektori për mbrojtjen e Mjedisit	/
Zyrtarët	Po	Zyrtarë mjedisor	/
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike	6
Sektori	Jo	Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	3
Zyrtarët	Po		/

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas deklaratave të zyrtarëve të SMMA është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil në SMM kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) kanë dhënë vlerësimin 4.

SMMA ka bërë të ditur se gjatë vitit 2024 për punonjësit e këtij sektori është organizuar vetëm një trajnim nga ana e GIZ dhe IKAP mbi menaxhimin e mbeturinave ku ka pasur të drejtë të merr pjesë vetëm një zyrtar.

Stafi i SMM gjatë vitit 2024 për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, kanë shfrytëzuar të gjitha Ligjet dhe Udhëzimet Administrative nga lëmia e Mjedisit dhe Planifikimit.

Statistikat Kryesore - 2024:

Kategoritë	Numri
Numri i zyrtarëve të angazhuar në DUPMM	1
Trajnimet rreth kornizës ligjore	1
Trajnimet sipas fushës mjedisore	0
Udhëzues Profesional për Planifikimin dhe Menaxhimin Mjedisor	0

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Gjakovës ka njoftuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Ligji për Mbrojtje të Mjedisit
 2. Ligji i Ndërtimit
 3. Ligji i Planifikimit
 4. Ligji për VNM
 5. Ligji për VSM
 6. Ligji për Ujërat
 7. Ligji për Natyrën
 8. Ligji për Mbeturina
- Si dhe ligjet tjera sektoriale që i përkasin sferës mjedisore.

Zyrtarët e Komunës së Gjakovës kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar pjesërisht, ku sipas tyre ligjet kryesisht janë adoptuar apo përkthyer, pa u përshtatur me specifikat e Kosovës, derisa në raste të caktuara edhe krijojnë dualizma dhe ndërhyrje tek njëri-tjetri, duke krijuar edhe konfuzitet.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 4 nga shkalla 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizim me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Komuna e Gjakovës ka aktiv Planin Lokal për Veprim në Mjedis, Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, HZK-në dhe Planin Lokal për Biodiversitet. Po ashtu SMMA ka pohuar se strategjitë mjedisore lokale janë të harmonizuara me ato qendrore.

SMMA në Gjakovë ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e mjedisit dhe gjelbërimit në komunë. Në kuadër të projektit "Eco Gjakova II," janë realizuar aktivitete të rëndësishme si shpërndarja e komposterëve, organizimi i ligjëratave vetëdijësuese në të gjitha shkollat e komunës dhe pastrimi i deponive ilegale. Ky projekt, i cili është zhvilluar nga janari deri në qershor 2024, ka pasur një buxhet prej 25,000 eurosh dhe është theksuar nevoja për vazhdimësinë e tij, -

-duke qenë se vetëdijesimi dhe riciklimi janë thelbësore për edukimin mbiekonominë qarkore, një nga prioritetet e BE-së.

Po ashtu, janë marrë masa për furnizimin dhe mbjelljen e fidanëve dhe drunjve dekorativë, me një plan të parashikuar për periudhën prill-qershor 2024 dhe një zotim financiar prej 150,000 eurosh, i cili është ende në procedurë. Krahas kësaj, është nënshkruar një marrëveshje për mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe mbjelljen e drunjve dekorativë, luleve si dhe mirëmbajtjen e rrugëve, me një vlerë totale prej 350,000 eurosh. Marrëveshja është realizuar me KRM Çabрати dhe pritet të zbatohet gjatë periudhës janar-qershor 2024.

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Sa i përket inspektiveve të zbatimit të kornizës ligjore, SMMA ka bërë të ditur se kjo çështje është përgjegjësi e Drejtorisë së Inspektorateve. Këta të fundit kanë raportuar se hartohen raporte javore, mujore dhe vjetore, lidhur me zbatimin e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve komunale dhe në rastin konkret sa i përket aspektit mjedisor, raportet i dërgohen drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese dhe Udhëheqësit të Sektorit.

Raportet kanë të bëjnë me: procesverbalet, urdhëresat e dhëna, gjobat e shqiptuara, aktvendimet e nxjerrura, fletëparaqitje e proceduara në Gjykatë, kërkesat e palëve etj.

Ndërsa kanë bërë të ditur se nuk hartohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore.

Për gjendjen e deponive të mbeturinave kanë raportuar Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Gjendja e deponive monitorohet përmes programit " My maps", ku janë të verifikuara dhe të ndara, në deponi të vogla, të mesme dhe mëdha. Komuna e Gjakovës, në bashkëpunim me GIZ dhe AMMK raporton çdo vit deponitë egzistuese përmes platformës Google "My maps". Kurse monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura nuk realizohet në këtë Komunë.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore zyrtarët kanë bërë të ditur se nuk janë identifikuar përveç hudhjes së mbeturinave në lokacione ilegale dhe ndotja e dëmtimi i lumenjve.

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Zyrtarët komunalë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kanë bërë të ditur se gjatë vitit të kaluar është monitoruar cilësia e ajrit në Komunën e Gjakovës. Është vendosur aparati për monitorimin e cilësisë së ajrit në qendër të qytetit në bashkëpunim me "Let's do it Peja" dhe Komunën e Gjakovës, mirëpo mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ajrit nuk ka.

Komuna e Gjakovës nuk ka sistem të monitorimit të dheut dhe mbikëqyrje sistematike të cilësisë së dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore e nëntokësoredhe mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ujit.

Sipas zyrtarëve komunalë, departamenti i mjedisit nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, ndërsa kapacitetet njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore sipas tyre janë të mjaftueshme.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Gjakovës bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si gati inekzistent. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel të kënaqshëm, ku përfshihen bashkëpunimet me organizatën Let's Do it Peja.

Sa i përket pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, Komuna e Gjakovës i zhvillon gjithmonë dhe rregullisht të gjitha dokumentet me pjesëmarrje publike, e që vlerësohet që janë të shumta. Kurse pjesëmarrjen publike në procese të tilla e vlerësojnë me 2, nga 1/aspak e kënaqshme deri 5/shumë e kënaqshme.

Licencimi dhe lejet mjedisore

Raportimi i Komunës mbi numrin e licencave dhe lejeve mjedisore aktive nuk është realizuar ngase është parë si kompetencë e MMPHI-Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Burimet njerëzore dhe financiare sipas tyre nuk janë të nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Në Komunën e Gjakovës, përgjegjës për menaxhimin mjedisor është Sektori për Mbrojtje të Mjedisit në kuadër të DUMM, por kjo drejtori nuk ka kthyer përgjigje për raportin. Informacioni është siguruar nga Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit në DShP, i cili ka 6 punonjës, prej tyre 3 të angazhuar në menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit.

Njohuritë e stafit komunal rreth kornizës mjedisore janë vlerësuar në nivel lartë, derisa kornizaligjore mjedisore nuk është mirë e konsoliduar sepse ka divergjenca dhe dualitete mes ligjeve që e trajtojnë të njëjtën materie.

Niveli i inspektimit si dhe hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë për shkak të mos shpalosjes së të dhënave në këtë drejtim, derisa është pranuar se në tregues të caktuar nuk ka monitorim.

SMMA në Komunën e Gjakovës ende nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm, derisa bashkëpunimi me shoqërinë civile në hartimin e politikave lokale është vlerësuar në nivel të mirë. Kurse pjesëmarrjen publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor e kanë vlerësuar me notën 2, nga 1-aspak e kënaqshme deri 5-shumë e kënaqshme.

REKOMANDIMET

- DUMM të sigurojë përgjigje të rregullta për raportet mjedisore për të përmirësuar transparencën dhe koordinimin institucional;
- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në SMMA;
- Të organizohen më shumë trajnime për punonjësit e SMMA rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;
- Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave mjedisore;
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore; dhe
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.